



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 maj 2014  
Nr.ref.:RK620/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI219/13**

Parashtrues

**Avdi Abdullahu**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Avdi Abdullahu nga fshati Gllamnik, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin SCEL-09-0001, të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme), të 24 shkurtit 2011, i cili iu dorëzua parashtruesit më 19 mars 2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, i cili pretendohet ta ketë penguar parashtruesin e kërkesës që të realizojë të drejtën e tij në 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”) në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë janë shkelur.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 3 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 janar 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI219/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI219/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 27 janar 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 25 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Parashtruesi pretendon se ai ishte punonjës i NSH “Ramiz Sadiku” për 8 (tetë) vjet.
10. Më 27 qershor 2006, NSH „Ramiz Sadiku“ e kishte përfunduar procesin e privatizimit.

11. Më 5 mars 2010, parashtruesi, i pakënaqur me vendimin e Agjencisë së Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Agjencia), e cila nuk e kishte përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë në një pjesë të 20% nga privatizimi, ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
12. Në ankesën drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi theksoi se ai ishte punëtor i NSH "Ramiz Sadiku", dhe se ai kishte punuar deri në vitin 1992, kur ai është dëbuar me dhunë nga puna. Parashtruesi i bashkëngjiti ankesës së Dhomës së Posaçme një kopje të vendimit, si provë e statusit të tij të punësimit në NSH "Ramiz Sadiku", si dhe një kopje të librezës së punës.
13. Agjencia, përmes një letre dërguar Dhomës së Posaçme, iu përgjigj ankesës së parashtruesit, duke pretenduar se parashtruesi nuk i plotëson kushtet, pasi që ai nuk ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor, i cili kishte skaduar më 27 mars 2009, kundër listës përfundimtare të punëtorëve, të hartuar nga Agjencia.
14. Më 24 shkurt 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori Aktvendimin SCEL-09-0001, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme. Në arsyetimin e vendimit të tij, Trupi gjykues deklaroi: *„Duke e marrë parasysh se ankesa është ushtruar tre muaj nga dita e skadimit të afatit për parashtrimin e ankesës (afati kohor për parashtrimin e ankesës ka skaduar më 27 mars 2009), në bazë të arsyeve të përmendura më lart nuk ka mundësi të miratohet kthimi në gjendjen e mëparshme dhe të konsiderohet ankesa si e afatshme; prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme”.*
15. Në përfundimin e Aktvendimit SCEL-09-0001, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme deklaroi: *„Në bazë të nenit 9,5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim pranë kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë shkelje procedurale të dispozitave ligjore dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, si dhe ka bërë shkeljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

*„Kërkesa ime është që 20% që është privatizuar ndërmarrja, që më është garantuar të më kompensohet siç i është kompensuar një pjesë të ish-punëtorëve të ndërmarrjes Ramiz Sadiku”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

18. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të

përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

20. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”.*

21. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*... ”*

*b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit;...”.*

22. Bazuar në informatat në shkresat e lëndës, Gjykata gjen se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 3 dhjetor 2013. Sipas shkresave në dispozicion, Gjykata përcaktoi se Aktvendimi i fundit, SCEL-09-0001, i Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, i është dorëzuar parashtruesit me 19 mars 2011, prandaj, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës.

23. Gjykata rikujton se qëllimi i rregullit katër (4) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) është që të promovojë sigurinë juridike, që të sigurojë që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, si dhe vendimet e nxjerra më herët të mos jenë të hapura pafundësisht për t’u kontestuar (shih, rastin O’Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).

24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e jashtëafatshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës,

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani